



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:268978

Datë: 27.01.2025

Numri i dokumentit: 06762009

ARJ.nr.254/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ragip Namani, kryetar, Muhamet Rexha dhe Beshir Islami, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, B.M., nga fshati H., Komuna F.K., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson, S. H., kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), me seli në P., me bazë juridike anulim aktit - vendimit administrativ nr. AZHB.07/4/01/50/2022 të datës 05.08.2022, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paditësit, ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.783/2023 të datës 06.09.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27 Janar 2025, merr:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e ushtruar nga paditësi B.M., nga fshati H., F.K., kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.783/2023 të datës 06.09.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit, AA.nr.783/2023 të datës 06.09.2024, është vendosur si në vijim: I. Aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me seli në P., II. Ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.441/18, i datës 13.09.2023, dhe çështja gjykohet si vijon: Refuzohet kërkesëpadia e paditësit, B.M., nga fshati H., Komuna e F. K., me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të paditurës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me seli në P., me nr. AZHB.07/4/01/50/2022 të datës 05.08.2022, dhe të detyrohet e paditura, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me seli në P., që paditësit në emër të kompensimit material të shkaktuar me vendimin e goditur në padi, t'ia paguaj shumën prej 71,874.81€ [shtatëdhjetë e njëmijë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër euro e tetëdhjetë e një cent], si dhe kompensimin e kontratës së qirasë në shumë prej 414.23€ [katërqind e katërmëdhjetë euro e njëzetë e tre cent] e në total shumën prej 72,289.04€ [shtatëdhjetë e dymijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë euro e katër cent], e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e

plotfuqishmërisë së aktgjykimit, si e pa bazuar. III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, paditësi përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor në këtë gjykatë parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, dhe shkeljes të drejtës materiale, me propozim që të: APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe të ANULOHET aktgjykimi i Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative, në Prishtinë, AA.nr.783/2023 të datës 06.09.2024 dhe të lihet në fuqi Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë A nr. 441/18, i dt. 13.09.2023.

Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar, dhe atij të shkallës së parë, sipas kërkesës së paditësit, si dhe shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kontestuar, nr. reference AZHB.07/4/01/50/2022, të datës 05.08.2022, të paditurës MBPZHR, është vendosur si në vijim: 1. Refuzohet mbështetja financiare për përkrahje në bujqësi dhe zhvillim rural për vitin 2017, për B.M.M., nga Fshati H., Komuna e F.K., për nën masën 101.1.c, sektori për pemë manore-fruta tjera manore. 2. Obligohet Divizioni i Miratimit të Projekteve të Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi. 3. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Kundër vendimit të paditurës, paditësi me padi fillon konflikt administrativ duke e kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin, A.nr.441/18, të datës 13.09.2023, në dispozitiv ka vendosur si në vijim: I. APROVOHET si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit B.M., nga fshati H., Komuna e F.K., të cilin me autorizim e përfaqëson S.H., II. ANULOHET vendimi me numër reference AZHB.07/4/01/50/2022 i datës 05.08.2022 i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. III. DETYROHET e paditura që paditësit në emër të kompensimit material të shkaktuar me vendimin e goditur në padi, t'ia paguaj shumën prej 71,874.81€ [shtatëdhjetë e njëmijë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër euro e tetëdhjetë e një cent], si dhe kompensimin e kontratës së qirasë në shumë prej 414.23€ [katërqind e katërmëdhjetë euro e njëzetë e tre cent] e në total shumën prej 72,289.04€ [shtatëdhjetë e dymijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë euro e katër cent], e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm. IV. Ky aktgjykim i zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues. V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj arsyeton ndër të tjera se: Në lidhje me këtë konflikt administrativ, gjykata me aktgjykimin A.nr.441/18 të datës 16.05.2022, kishte aprovuar padinë e paditësit si të bazuar duke e anuluar shkresën me titull "Informatë" me numër reference

07/4/3 të datës 09.11.2017 dhe çështjen e kishte kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura. Me parashtrësën e datës 08.07.2022 e paditura kishte njoftuar gjykatën se i nevojitet edhe një afat shtesë prej 30 ditësh për nxjerrjen e vendimit sipas aktgjykimit të gjykatës. Me parashtrësën e datës 28.09.2022, përfaqësuesi i autorizuar i paditësit e njofton gjykatën që e paditura nuk e ka nxjerrë vendimin sipas obligimit nga gjykata dhe në kohën e paraparë me ligj, andaj kërkon nga gjykata që mbi bazën e nenit 46, paragrafit 4 të Ligjit për Konfliktet Administrative, vetë gjykata të bëjë nxjerrjen e aktgjykimit meritor. Me datë 03.10.2022, gjykata dërgoi tek e paditura kërkesën për dhënien e njoftimit mbi shkaqet për të cilat nuk është nxjerrë akti administrativ, duke e detyruar të paditurën që brenda afatit prej 7 ditësh të njoftoj gjykatën. Me parashtrësën e datës 14.10.2022 e paditura e njofton përsëri gjykatën se duke marrë parasysh numrit të madh të lëndëve, nuk ka marrë vendim sipas obligimit nga gjykata. Gjykata gjeti se bazuar në nenin 125 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative se përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative.

Tutje theksohet se: Gjykata gjeti se edhe vendimi i ri i kontestuar nga ana e paditësit, pra vendimi i goditur me padi, është marrë me shkelje të dispozitave procedurale dhe materiale e gjithashtu edhe me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Gjykata konstatoi se marrja e vendimit të ri nga ana e të paditurës, nuk është bërë brenda afatit të paraparë ligjor, duke mos respektuar kështu aktgjykimin paraprak të gjykatës. Gjykata rivlerësoi se vendimi i atakuar përkatësisht pjesa hyrëse nuk i referohet fare Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht nuk përmban kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 47, paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 i LPPA-së. Gjykata po ashtu gjeti se edhe dispozitivi i vendimit të ri të atakuar në këtë konflikt administrativ, është në tërësi kontradiktor me arsyetimin dhe se arsyetimi nuk i përmbush asnjë nga kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 48 të LPPA-së. E paditura nuk i është përgjigjur asnjë pretendimi ankimor të paditësit, nuk ka bërë paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës, nuk ka shpjeguar situatën faktike dhe në mënyrë absolut nuk ka dhënë asnjë shkak për të cilin nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palës paditëse. Gjykata konstatoi se në procedurë administrative, organi kompetent publik fillimisht do të duhej shqyrtojë nëse ankesa është e pranueshme dhe, vetëm nëse ankesa është e pranueshme, të shqyrtojë ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e aktit administrativ. Nëse është e nevojshme, organi kompetent publik mund të kryente shqyrtime (hetime) administrative shtesë. E paditura në të dy rastet ka dështuar të shqyrtojë ankesën e paditësit në mënyrë të detajuar, t'i përgjigjet në formë të shkruar çdo pretendimi të ngritur nga ana e tij, të marrë në shqyrtim provat, t'i analizoj ato, të dëgjoj palën paditëse dhe të jap shpjegime të detajuara për secilin pretendim ankimor duke u siguruar që gjatë gjithë kohës zbatohen në mënyrë të plotë dhe të drejtë dispozitat ligjore të LPPA-së. E paditura nuk ka arritur të zbatoj në mënyrë të saktë dhe të drejtë ligjin material dhe gjendja faktike sërish e ka vërtetuar në mënyrë jo të plotë dhe jo të drejtë.

Në vazhdim ka theksuar se, e paditura edhe në vendimin e nxjerrë në procedurë të mëvonshme nuk ka arritur që të kundër argumentoj të gjitha argumentet e pretendimet e palës paditëse sa i përket gjendjes faktike të vërtetuar në terren me rastin e inspektimit nga ana e të paditurës. Organi i paditur ka dështuar të zbatoj nenin 95, paragrafin 1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme

Administrative, dispozitë ligjore kjo që e obligon organin publik, në këtë rast organin e paditur që të njoftoj palën, në këtë rast paditësin, për të drejtën e tij për tu dëgjuar. Kjo shmangie nga një detyrim ligjor i përcaktuar saktë, nuk u justifikua asnjëherë nga e paditura as me përgjigje në padi dhe në asnjë fazë të procedurës në këtë konflikt administrativ. Gjykata refuzoi pretendimet e të paditurës mbi arsyet e refuzimit të paditësit, përkatësisht se paditësit i mungon diploma e noterizuar, se i ka kryer obligimet tatimore si dhe CD-në, për faktin që nga shkresat e lëndës u vërtetua se të gjitha këto kërkesa janë përmbushur me kohë nga ana e paditësit. Për më tepër, përmbushjen e këtyre kriterëve, gjykata e vërtetoi edhe me vendimin e vet të paditurës me numër 07/4-5883 të datës 18.09.2017, ku në pjesën e arsytimit, në mënyrë decisive thuhet: *“Pas shqyrtimit të ankesës me numër të protokollit 4119 të datës 25.07.2017 konsideron të bazuar ankesën e aplikuesit, diploma është e noterizuar (pala ka sjellë edhe me ankesë diplomën me një akt noterial i cili besohet se i përket diplomës), gjithashtu komisioni ka thirrur aplikuesin dhe ka vërtetuar në shiqim Diplomën Universitare (Originale) e cila është identike me kopjen e noterizuar në aplikacion, gjithashtu sa i përket CD së dorëzuar aplikuesi ka dorëzuar 2 CD në momentin e aplikimit dhe arsyeja pse CD nuk hapet nuk është arsye për refuzim, sepse një kopje ka qenë edhe në zyrën regjionale. Ankuesi ka dorëzuar me ankesë CD dhe komisioni vërteton dokumentet e skanuara në këtë CD”*. Në vijim, gjykata refuzoi pretendimin e të paditurës për moskryerjen e obligimeve tatimore të paditësit, dhe kjo u vërtetua përmes vërtetimit Nr.2277/2017 të datës 13.02.2017, ku nuk evidentohet asnjë barrë tatimore.

Mbi këtë gjendje të fakteve, gjykata e shkallës së parë konstatoi se në këtë çështje administrative-juridike është shkelur ligji në dëm të paditësit dhe nuk janë respektuar as afatet ligjore për nxjerrjen e vendimit. Në këtë drejtim, gjykata gjeti se organi i paditur, aktgjykimin fillestar e ka pranuar me datë 06.06.2022, dhe ka qenë e obliguar që deri me datë 07.07.2022 të nxjerrë vendimin e ri. Në kundërshtim me të gjitha afatet ligjore, e paditura kishte nxjerr vendimin e ri tek me datë 05.08.2022. Meqenëse organi i paditur nuk mori parasysh vërejtjet dhe udhëzimet e gjykatës me aktgjykimin paraprak, gjykata vendosi në mënyrë meritore. Me propozimin e palës paditëse gjykata aprovoi nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare, dhe meqenëse e njëjta ishte nxjerrë konform të gjitha standardeve profesionale, gjykata të njëjtës i'a fali besimin e plotë. Në lidhje me këtë, gjykata hodhi poshtë pretendimet e palës së paditur rreth ekspertizës për faktin që të njëjtat nuk reflektonin mbi mënyrën e hartimit të ekspertizës financiare. Andaj në kuptim të nenit 5, 6, 38, 43, paragrafit 3, nenit 46, paragrafi 1, 2, 3, 4 dhe 5 të Ligjit për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata e Apelit e Kosovës duke shqyrtuar aktgjykimin brenda kufijve të ankesës e duke u nisur nga gjendje e tillë e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Kjo gjykatë ka vlerësuar se aktgjykimin i kontestuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, nën paragrafi n), dhe nga neni 183 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshme sipas nenit 63 të Ligjit për Konflikte Administrative, pasi që i njëjti është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij, dhe si i tillë është jo i plotë edhe në vërtetimin e gjendjes faktike, e rrjedhimisht edhe në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, andaj me vlerësimin ndryshe të shkresave dhe provave të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor nga gjykata e shkallës së parë, konstaton një gjendje tjetër

faktike nga ajo e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e së cilës gjendje faktike vjen në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pabazuar, për çka në këtë rast janë plotësuar kushtet e parapara ligjore që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet.

Në arsyetimin e aktgjykimit të saj, gjykata e shkallës së dytë ndër të tjera thekson se: Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e saj thekson se: *“Gjykata refuzoi pretendimet e të paditurës mbi arsyet e refuzimit të paditësit, përkatësisht se paditësit i mungon diploma e noterizuar, se i ka kryer obligimet tatimore si dhe CD-në, për faktin që nga shkresat e lëndës u vërtetua se të gjitha këto kërkesa janë përmbushur me kohë nga ana e paditësit”,* mirëpo këtë vlerësim të gjykatës së shkallës së parë nuk e përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm kolegji i gjykatës së apelit, për faktin se organi i paditur ka vepruar në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr.02/2017 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2017 dhe Ligjin Nr. 05/L-031 e Procedurës së Përgjithshme Administrative.

Mbi këto arsye sipas vlerësimit të kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë, organi i paditur drejtë ka vendosur kur me vendimin e kontestuar nga paditësi, ka gjetur se aplikuesi nuk ka dëshmuar se i ka të kryera obligimet tatimore sipas nenit 5 par.2, nënpar.2.1, pika 2.1.5 dhe pika 2.4.8, të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2017 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2017, pasi që vërtetimi i bashkangjitur në aplikacion nuk është në emër të aplikuesit, e as nuk përfshihet emri i aplikuesit, po ashtu aplikuesi në Planin e Biznesit, nuk e ka bashkangjitur tabelën e kthimit të investimeve, e cila duhet të jetë pjesë e Planit të Biznesit sipas modelit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Gjithashtu sipas vlerësimit të kolegjit të apelit, organi i paditur drejtë ka konstatuar se kontratat e noterizuara për qiramarrje të tokës bujqësore, nuk e përmbajnë pëlqimin e qiradhënësit për investim që do të bëhet në tokën e tij, siç kërkohet me nenin 5, paragrafi 2 nën paragrafi 2.4, pika 2.4.8 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2017 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2017. Mbi këto arsye, sipas vlerësimit të kolegjit të apelit, organi i paditur drejtë ka vendosur kur me vendimin e kontestuar nga paditësi ka refuzuar kërkesën për përkrahje në bujqësi dhe zhvillim rural për vitin 2017.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të kontestuar, shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjen se gjykata e shkallës së dytë drejtë ka vendosur me aprovimin si të bazuar të ankesës së të paditurës dhe ndryshimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Kjo, gjykatë e vlerëson si të drejtë qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit, pasi që aktgjykimi i kontestuar nuk është përfshirë me shkelje të pretenduara të dispozitave të procedurës administrative, me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, si dhe theksimeve të tjera, ashtu si pretendon paditësi në kërkesë pa dhënë fakte dhe prova konkrete lidhur me pretendimet e theksuara se i ka plotësuar kushtet ligjore për të drejtë në kompensim material. Edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate vendimi i të paditurës është vendim i drejtë dhe i ligjshëm dhe i nxjerrë në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 5 par.2, nënpar.2.1, pika 2.1.5 dhe pika 2.4.8, të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2017 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2017, ngase paditësi nuk ka përmbushur kriteret e përbashkëta dhe kriteret tjera të pranueshmërisë, për përkrahje financiare.

Pretendimin e paditësit të theksuar si në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, lidhur me shkeljen e dispozitave të procedurës nga neni 182 par. 2, pika (n) të LPK-së, kolegji i gjykatës Supreme e refuzoi si të pabazuar dhe të paqëndrueshëm. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktvendimi i kontestuar i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm. Në arsyetimin e aktvendimit të kontestuar janë dhënë mjaft arsye lidhur me faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, gjykata vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë dhe nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Gjykata shqyrtoj edhe pretendimin e paditësit, se e paditura ka lëshuar afatin për parashtrimin e ankesës në gjykatën e shkallës së dytë, dhe të njëjtin e refuzoi si të pabazuar dhe të paqëndrueshëm. Gjykata e shkallës së dytë drejtë ka vlerësuar afatshmërinë e ankesës, duke e trajtuar të njëjtën. Nga fletëdërgesa për dorëzim personal shihet se e paditura MBPZHR, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë e ka pranuar me datë 02.10.2023 ndërsa ankesën e ka parashtruar me datë 11.10.2023, verifikuar sipas aktit të Zyrës së Pranimit me nr. të dokumentit (SMIL), dhe vulës së protokollit të gjykatës së shkallës së parë, nga çka rezulton se ankesa është parashtruar brenda afatit të përcaktuar ligjor, përkatësisht brenda 15 ditësh, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat ligjore nga neni 49 par.2 të LKA-së.

Edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, ngase i njëjti është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, nën paragrafi n), dhe nga neni 183 të LPK-së aplikueshme sipas nenit 63 të LKA-së. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, në pjesën arsyetuese të tij, nuk ka përmbajtje koherente në rrjedhë logjike dhe juridike, i njëjti është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij, kundërthënës edhe në vërtetimin e gjendjes faktike , e si rrjedhojë ka rezultuar edhe me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, andaj me të drejtë është ndryshuar nga gjykata e shkallës së dytë, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Mbi këto arsye, Gjykata Supreme vlerëson se pretendimet e paditësit si në kërkesë janë të pabazuara dhe jo me ndikim për vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë. Aktgjykimi i kontestuar i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm, po ashtu edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë dhe nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit.

Nga theksimet si më lartë, e në bazë të nenit 54 paragraf 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË
ARJ.nr.254/2024, më datë 27 janar 2025

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani